



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Pyetje dhe përgjigje mbi Rregulloren e Brendshme “Për sigurinë, rendin, solemnitetin dhe rregullat e sjelljes në ambientet e GJKKO-së”

1. Çfarë synon Rregullorja e Sigurisë?

Kjo rregullore synon të mbrojë jetën, shëndetin, dinjitetin dhe sigurinë e gjyqtarëve, punonjësve të administratës gjyqësore, personelit mbështetës, palëve në proces, avokatëve, prokurorëve, dëshmitarëve, ekspertëve, përkthyesve, bashkëpunëtorëve të drejtësisë, personave të paraburgosur, vizitorëve, publikut dhe medias; të mbrojë dokumentacionin, sistemet dhe godinën e Gjykatës, si dhe të garantojë zhvillimin normal, të sigurt dhe solemn të procesit gjyqësor. Masat mbështeten në ligjshmëri, proporcionalitet, parandalim, neutralitet dhe trajtim të barabartë (*neni 1 i Rregullores*).

2. Për kë dhe ku zbatohet Rregullorja?

Ajo zbatohet në të gjitha ambientet e brendshme dhe të jashtme nën administrimin ose përdorimin e Gjykatës, përfshirë hyrjet, daljet, hollin, korridoret, sallat, parkingun dhe perimetrin e sigurisë. Zbatohet gjatë dhe jashtë orarit zyrtar ndaj çdo personi që hyn, qëndron ose ushtron veprimtari në Gjykatë (*neni 4 i Rregullores*).

3. Si vlerësohet siguria e një seance gjyqësore?

Çdo seancë gjyqësore zhvillohet me masa sigurie që i përshtaten nivelit konkret të riskut. Në varësi të interesit publik, numrit të pjesëmarrësve, profilit të çështjes dhe informacioneve eventuale për kërcënime, seanca klasifikohet në një nga katër nivelet: normal; i shtuar; i lartë; kritik. Masat e posaçme administrative zbatohen vetëm kur janë të nevojshme dhe nuk cenojnë kompetencat procedurale të trupit gjykues. Komiteti i Sigurisë kryen vlerësim të gjendjes së sigurisë jo më rrallë se një herë në vit, ndërsa gjetjet përdoren për përditësimin e masave, planeve të reagimit dhe trajnimeve (*nenet 8, 9 dhe 153 të Rregullores*).

4. A janë seancat gjyqësore të hapura për publikun?

Po. Seancat gjyqësore publike janë të hapura për publikun. Ky i fundit mund të ndjekë seancat publike deri në plotësimin e kapacitetit të sallës, duke respektuar organizimin e saj dhe

udhëzimet e personelit të sigurisë. Kur seanca zhvillohet me dyer të mbyllura ose kalon në seancë jo publike, publiku dhe media largohen qetësisht sipas udhëzimeve të personelit të sigurisë.

Në seancat gjyqësore publike nuk pranohen si publik të miturit nën moshën 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjeç, personat në gjendje dehjeje ose intoksikimi, si dhe personat që, për shkak të gjendjes së tyre të dukshme, nuk janë në gjendje të respektojnë rendin, solemnitetin dhe sigurinë e seancës (*nenet 65, 81, 82 dhe 89 të Rregullores*).

5. Çfarë procedure duhet të ndjekë çdo person që hyn në Gjykatë?

Çdo person duhet të paraqesë një dokument identifikimi dhe t'i nënshtrohet kontrollit fizik dhe elektronik nga personeli i sigurisë dhe/ose Garda e Republikës. Refuzimi për t'iu nënshtruar kontrollit ose pamundësia e konfirmimit të identitetit sjell ndalimin e hyrjes. Pas kontrollit, personi ka të drejtë të lëvizë në zonat publike sipas itinerarit dhe sinjalistikës orientuese (*nenet 24, 28, 29 dhe 40 të Rregullores*).

6. Si veprohet me sendet që nuk lejohen të futen në ambientet e Gjykatës?

Personat mund të mbajnë me vete sende të zakonshme personale, me kusht që ato të mos cenojnë sigurinë, rendin ose solemnitetin e institucionit. Sendet **që nuk lejohen** në zonat përkatëse, por që mund të ruhen në mënyrë të sigurt, merren përkohësisht nga personeli i sigurisë, vendosen në raftet, kasetat ose vendet e përcaktuara për ruajtjen e tyre dhe i kthehen personit në dalje.

Nuk lejohen të futen në Gjykatë: armët, municionet, eksplozivët, thikat dhe sendet e tjera të mprehta, substancat e rrezikshme, alkooli, enët prej qelqi, çantat me përmasa shumë të mëdha, pajisjet e fshehta regjistruese, dronët, si dhe materialet me karakter kërcënues ose propagandistik.

Kur mbajtja e sendit përbën vepër penale, njoftohen organet kompetente (*nenet 30 dhe 31 të Rregullores*).

7. A mund të bëhet publik Plani i Sigurisë?

Planet operative të sigurisë, vendndodhja e kamerave të sigurisë, kodet e alarmit, itineraret e të paraburgosurve, hyrjet e gjyqtarëve, ambientet e dëshmitarëve të mbrojtur, protokollet kritike dhe të dhënat mbi sistemet e sigurisë janë dokumente për përdorim të brendshëm, aksesit në të cilat kufizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi (*neni 156 i Rregullores*).

8. Çfarë ndodh kur salla nuk ka vende të mjaftueshme për të gjithë të interesuarit?

Vendet administrohen nën kujdesin e gjyqtarit/kryesuesit të trupit gjykues, sipas kësaj radhe përparësie: i) subjektet në gjykim; ii) familjarët dhe iii) përfaqësuesit e akredituar të medias. Kur numri i familjarëve është më i madh sesa numri i vendeve në sallë, nëpunësi për marrëdhëniet me publikun dhe median, nën kujdesin e gjyqtarit ose të kryesuesit të trupit

gjykues, cakton një kuotë vendesh në sallë për familjarët, në mënyrë që të ruhet një kuotë përfaqësuese vendesh për përfaqësuesit e akredituar të medias (*neni 65 i Rregullores*).

9. A duhet respektuar një kod veshjeje brenda ambienteve të Gjykatës?

Po. Çdo person duhet të paraqitet me veshje të rregullt dhe dinjitoze, të përshtatshme me solemnitetin e institucionit. Kur veshja është tepër e zbuluar, sportive ose përmban mesazhe fyese, kërcënuese, diskriminuese, politike apo propagandistike, personit i kërkohet ta përshtatë atë përpara se të lejohet të hyjë në ambientet e Gjykatës (*nenet 49 dhe 75 të Rregullores*).

10. Çfarë është akreditimi i medias dhe cili është funksioni i tij?

Akreditimi është një procedurë administrative që shërben për organizimin e marrëdhënieve ndërmjet Gjykatës dhe medias në bazë të ligjshmërisë, barazisë, transparencës, proporcionalitetit dhe sigurisë juridike. Nëpërmjet tij realizohen njëkohësisht identifikimi institucional, administrimi racional i aksesit, garantimi i sigurisë, kufizimi i diskrecionit administrativ, mbrojtja e të drejtave procedurale të medias dhe forcimi i besimit të publikut në paanshmërinë e sistemit gjyqësor.

Një institucion publik nuk mund të administrojë marrëdhëniet me median në bazë të njohjeve personale, praktikave informale, preferencave individuale ose vlerësimeve spontane. Funksioni i akreditimit është të garantojë administrimin e marrëdhënieve të Gjykatës me median sipas procedurave të qarta, objektive, transparente, të verifikueshme dhe të njëjta për të gjithë.

Akreditimi nuk është një kufizim i lirisë së medias, por një garanci procedurale për ushtrimin e kësaj lirie në mënyrë të barabartë, të paanshme, të sigurt dhe në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës.

Akreditimi nuk është as licencë për ushtrimin e gazetarisë, as autorizim për informimin e publikut. Gjykata nuk ka kompetencë ta japë ose ta heqë këtë të drejtë. Për rrjedhojë, **akreditimi nuk krijon, ndryshon ose shuan të drejtën e medias për të informuar publikun dhe nuk kushtëzon ushtrimin e profesionit të gazetarit.**

11. Çfarë mundëson akreditimi dhe cilat janë kufijtë e tij?

Akreditimi mundëson aksesin e rregullt në ambientet e Gjykatës, ndjekjen e seancave gjyqësore publike në varësi të numrit të vendeve të disponueshme në sallë, marrjen e njoftimeve të Gjykatës dhe të ftesave për takime informuese, komunikime me median dhe konferenca për shtyp.

Akreditimi nuk krijon të drejtë automatike për regjistrim filmik, fotografim, regjistrim audio ose transmetim të seancave gjyqësore.

Akreditimi është vjetor, personal dhe i patransferueshëm. Karta e akreditimit përdoret vetëm nga personi të cilit i është lëshuar.

Kërkesa për akreditim shqyrtohet dhe vendimi njoftohet brenda 5 (pesë) ditëve nga paraqitja e dokumentacionit të plotë. Kalimi i këtij afati pa njoftim me shkrim konsiderohet miratim i heshtur (*nenet 90 dhe 93 të Rregullores*).

12. Kush mund të paraqesë kërkesë për akreditim pranë Gjykatës dhe cilat dokumente duhet të paraqiten?

Pranë Gjykatës mund të paraqesë kërkesë për akreditim çdo gazetar, kameraman, fotograf, teknik transmetimi etj., që përfaqëson një televizion, radio, gazetë, portal online, blog ose agjenci lajmesh. Kërkesë për akreditim mund të paraqesë edhe gazetari i pavarur (freelancer), i cili ushtron veprimtari profesionale gazetareske pa u paraqitur në emër të një subjekti mediatik të caktuar.

Për pajisjen me akreditim, aplikanti paraqet:

- a) formularin e plotësuar të akreditimit;
- b) një dokument identifikimi të vlefshëm;
- c) kartë shtypi ose dokument tjetër që provon statusin profesional;
- ç) kur përfaqëson një subjekt mediatik, autorizim ose vërtetim nga subjekti përkatës; ndërsa, kur ushtron veprimtarinë si gazetar i pavarur (freelancer), një ose më shumë prova të verifikueshme të ushtrimit të veprimtarisë profesionale gazetareske gjatë 12 muajve të fundit;¹
- d) fotografi standarde për dokument identifikimi, për përgatitjen e kartës së akreditimit;
- dh) Deklaratën e Njohjes dhe Respektimit të Rregullave të Sigurisë, Rendit dhe Sjelljes në ambientet e Gjykatës, të plotësuar dhe të nënshkruar.

(*Neni 90 i Rregullores dhe Aneks nr. 7 dhe 8, bashkëlidhur asaj*).

13. A mund të ndjekë një seancë gjyqësore publike gazetari i paakredituar?

Po. Gazetari i paakredituar mund ta ndjekë seancën gjyqësore publike në të njëjtat kushte si publiku, sipas radhës së paraqitjes dhe në varësi të vendeve të disponueshme në sallën e gjyqimit. Procedurat dhe lehtësitë e posaçme të aksesit të medias u përkasin përfaqësuesve të akredituar (*nenet 65, 90 dhe 93 të Rregullores*).

14. Si realizohet ndjekja e një seance gjyqësore publike nga përfaqësuesit e akredituar të medias?

Përfaqësuesit e akredituar të medias të pajisur me akreditim kanë të drejtë të ndjekin seancat gjyqësore publike, në përputhje me këtë rregullore dhe në varësi të vendeve të disponueshme në sallën e gjyqimit, pa qenë e nevojshme të paraqesin një kërkesë për autorizim paraprak.

¹ Veprimtaria profesionale gazetareske gjatë 12 muajve të fundit mund të provohet nëpërmjet një ose më shumë prej dokumenteve ose të dhënave të mëposhtme: kopje ose lidhje elektronike të materialeve të publikuara, vërtetime ose kontrata bashkëpunimi me subjekte mediatike, portofol profesional publik ose çdo dokument tjetër të verifikueshëm që dëshmon ushtrimin faktik të veprimtarisë gazetareske.

Për ndjekjen e seancave gjyqësore publike do të vijojë të ndiqet e njëjta procedurë që është ndjekur deri më sot nga GJKKO.

Vetëm në rastet përjashtimore kur, për shkak të kapacitetit të sallës, kërkesave të sigurisë, interesit të lartë publik ose nevojave të administrimit të rregullt të procesit gjyqësor, është e nevojshme të administrohet akses i medias, kryesuesi i trupit gjykues vendos për zbatimin e procedurës së administrimit të aksesit.

Vetëm kryesuesi i trupit gjykues gëzon autoritetin për të vlerësuar nëse kapaciteti i sallës, kërkesat e sigurisë, interesi i lartë publik ose nevojat e administrimit të procesit e bëjnë të nevojshëm zbatimin e procedurës së posaçme të administrimit të aksesit. Në këto raste, ai përcakton numrin maksimal të përfaqësuesve të medias që mund të ndjekin seancën dhe, kur është e nevojshme, përdorimin e sistemit “media pool”, të një salle alternative për median ose të formave të tjera organizative të parashikuara në Rregullore. Këto masa lidhen me kompetencën e trupit gjykues për të garantuar rendin dhe zhvillimin normal të seancës.

Në rastet e zbatimit të procedurës së administrimit të aksesit, administrata e Gjykatës njofton publikisht mediat për mënyrën dhe afatin e regjistrimit për pjesëmarrje. **Regjistrimi është procedurë për administrimin e vendeve dhe jo kërkesë për leje për të ndjekur një seancë gjyqësore publike** (neni 93 i Rregullores).

15. Kush vendos për pezullimin apo revokimin e akreditimit të përfaqësuesve të medias?

Pezullimi ose revokimi i akreditimit vendoset me urdhër të arsyetuar të kryetarit të Gjykatës ose të personit të autorizuar prej tij, vetëm në bazë të provave konkrete të mbledhura për shkeljen përkatëse, pas dëgjimit të përfaqësuesit të medias ose subjektit mediatik të interesuar, dhe pas marrjes së mendimit paraprak, jodetyrues, të strukturës përgjegjëse për median pranë Gjykatës (neni 98 i Rregullores).

16. A mund të ankimohet vendimi për refuzimin, pezullimin ose revokimin e akreditimit?

Po. Vendimi për refuzimin, pezullimin ose revokimin e akreditimit mund të ankimohet pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, sipas procedurave dhe afateve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

17. Çfarë lejohet dhe çfarë nuk lejohet në sallën e gjykimit?

Të pranishmit mund të ndjekin seancën nga vendet e caktuara, në qetësi dhe me respekt për Gjykatën dhe pjesëmarrësit, si dhe të mbajnë shënime. Prokurorët, të pandehurit, viktimat dhe avokatët mund të mbajnë me vete dhe të përdorin kompjuterë portativë (laptopë) për ushtrimin e funksioneve të tyre procedurale. Personave me aftësi të kufizuara u lejohet mbajtja dhe përdorimi i pajisjeve elektronike ndihmëse të domosdoshme.

Në sallën e gjykimit nuk lejohen bisedat me zë të lartë, reagimet demonstrative, ndërhyrjet, komunikimi pa leje me të pandehurin, hyrje-daljet gjatë seancës pa lejen e trupit gjykues, mbajtja dhe përdorimi i telefonave celularë dhe i pajisjeve të tjera elektronike, përveç rasteve të parashikuara në Rregullore. Gjithashtu, ndalohet çdo fotografim, filmim ose transmetim pa autorizim (*nenet 73, 74, 76 dhe 77 të Rregullores*).

18. Si realizohen filmimi, fotografimi, regjistrimi audio ose transmetimi i një seance nga media?

Media paraqet kërkesë të paktën 24 orë përpara orës së caktuar për fillimin e seancës gjyqësore dhe veprimtaria realizohet vetëm pas autorizimit paraprak të trupit gjykues, sipas kushteve të përcaktuara prej tij. Ekipet filmike dhe pajisjet e regjistrimit hyjnë në sallë vetëm pas marrjes së autorizimit. Pajisjet e medias nuk duhet të pengojnë zhvillimin e seancës, qarkullimin e personave, masat e sigurisë ose komunikimin ndërmjet subjekteve procedurale (*neni 95 i Rregullores*).

19. A mund të realizojë vetë Gjykata regjistrimin audioviziv të seancave gjyqësore dhe ta vërë në dispozicion medias?

Po. Gjykata mund të realizojë vetë regjistrimin audioviziv të seancave gjyqësore publike nëpërmjet sistemeve dhe pajisjeve të saj zyrtare, kur kjo vlerësohet e nevojshme. Vendimi për realizimin e regjistrimit audioviziv, si dhe për përcaktimin e pjesëve të seancës që do të regjistrohen, transmetohen ose vihen në dispozicion të medias, merret nga trupi gjykues (*neni 79 i Rregullores*).

20. A mund të realizohen filmime, fotografime ose intervista në hollin e Gjykatës?

Autorizimi për filmime, fotografime ose intervista në holl jepet nga kryetari i Gjykatës ose nga personi i autorizuar prej tij dhe mund të kufizohet për arsye sigurie, për mbrojtjen e jetës private dhe të dëshmitarëve, ruajtjen e dinjitetit të personave ose garantimin e zhvillimit normal të veprimtarisë gjyqësore (*neni 57 i Rregullores*).

21. A i nënshtrohet Rregullorja rishikimit dhe në cilat raste?

Po. Rregullorja rishikohet të paktën një herë në dy vjet ose sa herë që paraqitet nevoja për shkak të ndryshimeve ligjore, organizative, teknologjike ose të sigurisë. Gjithashtu, Rregullorja, Plani i Sigurisë, procedurat operative dhe protokollet e emergjencës rishikohen pas çdo ushtrimi praktik, pas çdo incidenti serioz, pas ndryshimeve në infrastrukturë, pas ndryshimeve në sistemet teknike ose pas rekomandimeve të institucioneve kompetente (*neni 158 i Rregullores*).

Tiranë, më datë 31.08.2026

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar